

REPUBLIKA E SHqipërisë

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr.1537 Regj.  
Nr 1537/7 Prot.

Tiranë, më 28.09.2022

**Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

**Për dijëni: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

*Adresa: Tiranë*

Në vijim të përgjigjes tuaj nr. 22787/1 prot datë 14.09.2022 “*Kthim Përgjigje*” protokolluar nga ana e “JUS” shpk me nr. 4655 prot datë 16.09.2022 ku kërkonti saktësimin e NUIS ( NIPTI) të debitorit ju bëjmë me dije se:

Referuar **Urdhrit të Ekzekutimit: Vendimi nr. 867 datë 05.05.2022 i Gjykatës Administrative Shkallë e Pare Tiranë i cili ka vazhduar në fazën procedurale të ekzekutimit të detyrueshëm subjekti debitor rezulton: “KLEIT MARVI” sh.p.k NUIS: L86821006B.**

*Bashkëngjitur do të gjeni, Urdhër Për Saktësimin E Urdhërit Nr.1537/4 Prot Datë 26.08.2022 “Për Vënien E Sekuestros Konservative”*

**PËRMBARUES GJYQËSOR**


**Mario HASANLIU**





REPUBLIKA E SHOIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



Nr.1537 Regj.  
Nr 1537/8 Prot.

Tiranë, më 28.09.2022

**URDHËR**  
**PËR SAKTËSIMIN E URDHËRIT NR.1537/4 PROT DATË 26.08.2022**  
**“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

Pranë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat “JUS” sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër Regj 1537 me palë:

Kreditor: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

Debitor: “KLEIT MARVI” sh.p.k NUIS: L86821006B

Objekti: Pagim Gjobe

Une përmbaruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarimore:

**KONSTATOVA:**

Në titullin ekzekutiv : **Vendim dënimi me gjobë Nr. 92 datë 25.06.2021 të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**, është përcaktuar detyrimi juaj si palë debitore të paguani shumën totale të detyrimit në favor të palës kreditore **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**, për dënimin me gjobë, në vlerën **1.000.000 lekë**, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjobën e pashlyer të përlllogaritur nga **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit** në vlerën **600.000 lekë**. Tarifa përmbarimore për shumën totale të detyrimit është në vlerën **192.000 lekë me TVSH**

Për këtë titull ekzekutiv është lëshuar **Urdhrit te Ekzekutimit: Vendimi nr. 867 datë 05.05.2022 i Gjykates Administrative Shkalle e Pare Tiranë**

Për ekzekutim të vendimit gjyqësor të mësipërm pala debitore është lajmëruar që detyrimin ta përbushë në mënyrë vullnetare me shkresën nr. 1537/1 prot datë 08.08.2022. Afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ka kaluar por pala debitore nuk ka dokumentuar asnjë veprim për ekzekutim të këtij titulli ekzekutiv.

Në këto kushte ekzekutimi i titullit do të vazhdojë në fazën procedurale të ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij deri në masën që do të jetë e nevojshme për plotësim të detyrimit.

**Për këtë arsye :**

Në bazë të neneve 527, 593 e në vijim të K.Pr.Civile e U. B. Sh "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka”

## URDHËROJ:

- 1- **Qendra Kombëtare e Biznesit** brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të verifikojë nëse ekzistojnë kuota/aksione/aktive dhe biznese të regjistruara në emër të debitorit **“KLEIT MARVI” sh.p.k NUIS: L86821006B** dhe nëse ka të tilla të kryejnë vendosjen e sekuestros mbi kuotat dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për shumën e detyrimit në total prej **1.792.000 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë**
- 2- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 3- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin **598 e në vijim te K.Pr.Civile**, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**Mario HASANLLIU**

